



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo za Obrazovanje i Nauku / Ministry of Education and Science

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nenit 11 paragrafit 1.5 të Ligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 34/18 nëntor 2022), në mbështetje të nenit 4 paragrafit 1.7, nenit 8 dhe shtojcës 7 të Rregullores (QRK) nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të datës 09.08.2023, nenit 32, paragrafit 4 të Ligjit 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, të datës 14 shtator 2011 dhe nenit 5, 6, 7, 8 të Udhëzimit administrativ nr. 20/2023 të datës 04.08.2023 për Krijimin e Skemave për Mbështetje Financiare të Studentëve për Ndarjen e Bursave dhe Vendimin e Ministres nr. 01-148 dt. 23.09.2025, shpall:

KONKURS

Për ndarje të bursave elitare për studentët e universiteteve publike në programet baçelor dhe master, dhe mbështetjen financiare për studentët me aftësi të kufizuara për vitin akademik 2025-2026

Kushtet dhe kriteret

1. Të drejtë aplikimi për bursë kanë të gjithë studentët në nivelin BA dhe MA që studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë, të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara:

2. Kriteret për nivelin Baçelor:

2.1 Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;

2.2 Të jenë të regjistruar në IAL publike në Kosovë;

2.3 Ta kenë përfunduar vitin e parë të nivelit baçelor;

2.4 Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve;

2.5 T'i kenë përfunduar të gjitha provimet e vitit akademik paraprak të përcaktuar me program studimor dhe në afat kohor të rregullt (afati i muajit shtator);

2.6 Ta kenë të regjistruar semestrin vijues në programin studimor;

2.7 Të kenë notë mesatare të studimeve së paku 9 (përfshijmë pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian ku nota mesatare duhet të jetë së paku 8 me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së përfshirjes së tyre në arsimin e lartë);

2.8 Studentët që i kanë përfunduar ligjëratat në vitin e fundit të studimeve të nivelit bachelor nuk mund të përfitojnë bursë.

2.9 Për studentët me aftësi të kufizuara nuk vlenë kriteri i notës mesatare.

3. Kriteret për bursa të nivelit Master:

3.1 Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;

3.2 Të jenë të regjistruar në IAL publike në Kosovë;

3.3 Ta kenë përfunduar vitin e parë të nivelit master;

3.4 Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve;

3.5 T'i kenë përfunduar të gjitha provimet e vitit akademik paraparak të përcaktuar me program studimor dhe në afat kohor të rregullt (afati i muajit shtator);

3.6 Ta kenë të regjistruar semestrin vijues në programin studimor;

3.7 Të kenë notë mesatare të studimeve së paku 9 (përfshijmë pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian ku nota mesatare duhet të jetë së paku 8 me qëllim të përmirësimit dhe rritjes së përfshirjes së tyre në arsimin e lartë);

3.8 Të drejtë aplikimi për bursë në nivelin master kanë të gjithë ata që studiojnë në programe njëvjeçare dhe dyvjeçare.

3.9 Studentët e regjistruar në program të studimeve dyvjeçare master nuk mund të përfitojnë bursë më shumë se dy herë brenda programit të studimit të rregullt akademik (që nënkupton se aplikimi fillestar bëhet në vitin e parë të studimeve në nivelin master, ndërsa aplikimi i dytë bëhet në përfundim të vitit të parë me sukses, në afat të rregullt akademik);

3.10. Studentët e regjistruar në program të studimeve njëvjeçare master nuk mund të përfitojnë bursë më shumë se një herë brenda programit të studimit të rregullt akademik;

3.11 Studentët që vijnë studime të integruara me kohëzgjatje pesëvjeçare nuk mund të përfitojnë bursë më shumë se katër herë brenda programit dhe afatit të rregullt akademik.

3.12 Për studentët me aftësi të kufizuara nuk vlenë kriteri i notës mesatare.

4. Kategoritë e studentëve me përparësi:

4.1 Në kushte të barabarta, përparësi për përfitimin e bursës nga Ministria, do të kenë kandidatët që i përketin kategorive me përparësi të cilët janë të përcaktuar sipas ligjeve në fuqi dhe që specifikohen sipas këtij konkursi;

4.2 Studentët me aftësi të kufizuara mund të përfitojnë bursë vetëm brenda dyfishit të afatit të rregullt të studimeve të paraparë me legjislacionin në fuqi, varësisht nga kohëzgjatja e programit.

5. Dokumentacioni që kërkohet:

Studentët/et të cilët/at i plotësojnë kushtet, duhet t'i dorëzojnë dokumentet në vijim në përputhje me formatin e përcaktuar në konkurs;

5.1 Vërtetimin e statusit të studentit;

5.2 Pasqyrën e notave me notë mesatare dhe ECTS kredi të lëshuar nga fakulteti;

5.3 Konfirmimin e xhirollogarisë bankare personale aktive;

5.4 Kopjen e letërnjoftimit;

5.5 Për studentët me aftësi të kufizuara dëshmitë relevante të lëshuara nga organet kompetente (Vlenë për studentët e nivelit bachelor & master);

5.6 Për studentët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, vetëdeklarimin për përkatësinë etnike (Vlenë për studentët e nivelit bachelor & master);

5.7 Për studentët e programeve njëvjeçare master: Diplomën origjinale/Kopjen e diplomës së noterizuar të nivelit BA, pasqyrën e notave origjinale (ose kopjen e noterizuar) me notë mesatare së paku 9 dhe vërtetimin që është regjistruar në nivelin MA;

Procedurat e aplikimit

Aplikimi bëhet online në platformën e-Kosova në linkun e publikuar në thirrje.

Informata shtesë

- Dokumentet e pakompletuara do të refuzohen nga komisioni.
- Dokumente të pakompletuara janë:

Mungesa e dokumenteve të kërkuara sipas thirrjes;

Dokumentet e dorëzuara/ngarkuara pjesërisht (të cilave u mungojnë faqet);

Dokumentet e panëshkruara, pavulosura dhe të pa protokolluara nga institucioni përkatës.

- Aplikimet me gabime/lëshime teknike nga ana e aplikuesve në dorëzimin/ngarkimin e dokumenteve do të refuzohen nga komisioni.
- Dokumentet e dorëzuara në Ministri nuk kthehen, përkatësisht asgjësohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Aplikantët të cilët dorëzojnë/ngarkojnë dokumente me përmbajtje të pavërtetë dhe ofrojnë të dhëna të rrejshme nga ato që figurojnë në dokumentet zyrtare do të eliminohen automatikisht nga konkursi dhe mund t'ju mohohet e drejta për aplikimet e radhës.
- Aplikantët nuk mund të jenë përfitues të bursës nga më shumë se një skemë e bursave nga Ministria brenda të njëjtit vit akademik.
- Lista e studentëve përfitues do të bëhet publike në uebfaqen e MASHTI.
- **Konkursi do të jetë i hapur nga data 03.10.2025 deri më 18.10.2025, në ora 16:00.**

E drejta e ankesës: Kandidatët që kanë aplikuar për përfitim të bursës, kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh kalendarike, pas shpalljes së rezultateve. Ankesat dorëzohen në arkivin e MASHTI, kati përdhes, zyra nr. 4 dhe shqyrtohen nga komisioni për ankesa dhe parashtresa i MASHTI.